

Komunikim për median. Tërmeti i datës 21.09.2019.

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Ndërtimit në Shqipëri Agron Hysenlliu i ftuar në rubrikën “Opinion” në “News 24” foli për tërmetin e rënë në vend, duke thënë se pasojat nuk ishin të rënda.

Hysenlliu u shpreh se tërmeti ishte goxha i madh dhe pasojat nuk ishin të rënda. Sipas tij, kjo tregon se puna e inxhinierëve të ndërtimit ka qenë e mirë.

“Në tërësi, objektet e vjetra kanë probleme. Tërmeti që ka rënë në vendin tonë, meqë jam në terren dhe kam parë gjitha godinat, e ata kanë rezistuar. Kjo tregon se kolegët e mi inxhinierë kanë punuar me ndershmëri dhe përpikmëri. Kjo dëshmon më së miri se inxhinierët kanë punuar mjaft mirë. Hyn në tërmetet e mëdhenj dhe ndërtimet e mëdha kanë rezistuar”, tha Hysenlliu.

Agron Hysenlliu deklaroi se testi i madh kaloi dhe se tek qytetarët nuk duhet të ketë as panik e as frikë.

“Ky ishte një test i madh. Derisa objektet kanë rezistuar me një tërmet 5.8 ballë, tregon se ata janë të forta. Në inxhinieri nuk thuhet nëse ky objekt bie ose jo. Ne themi ka risk. Objektet e vjetra kanë risk më shumë për të rënë. Vjetërsia e objektit e bën atë më të dobët, edhe për shkak të përdorimit, duke humbur fortësinë e tyre. Objektet e reja janë bërë me një hekur dhe beton të një shkalle të lartë. Lidhja e hekurit dhe betonit është rritur në shkallë të lartë. Ky ishte test i madh për ndërtimet në Tiranë, Elbasan, Durrës etj dhe tregon se inxhinierët shqiptarë e njohin fushën e ndërtimit”, tha Hysenlliu.

Agron Hysenlliu theksoi se do të bëhet hetim për çdo banesë, nëse ajo reziston apo jo dot ndaj tërmeteve.

Më poshtë gjeni linkun ku mund të dëgjoni të gjithë intervistën.

<https://youtu.be/WBREKGJzQ08>